



Datë: 16.06.2025
Numër Protokolli: 5006/2025

A.nr.738/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.738/2025, të datës 28.04.2025, të parashtruar nga ankuesja L.M, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Arbër Shala nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Ministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*transferim si rezultat i ristrukturimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 16.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.738/2025, të datës 28.04.2025, të parashtruar nga ankuesja L.M.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile L.M (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesja), përmes përfaqësuesit të saj me autorizim, më datë 28.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit MMPHI-299/2025, të datës 18.03.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrit të Punëve të Brendshme, për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe rregulloreve përkatës dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje MMPHI), ndërsa, kjo e fundit, më datë 13.06.2025, ka përcjell dokumentacionin lidhur me çështjen në procedurë.

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezultojnë se ankuesja sipas Aktit të Emërimit të datës 01.07.2015 është emëruar dhe e njëjti ka ushtruar pozitën *Përkthyes*, në Sektorin e Logjistikës në kuadër të Ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, tashme Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Tutje sipas Vendimit me Nr.073/2024, të datës 29.03.2024, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është miratuar Rregullorja (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin me Nr.2392/2024, të datës 29.11.2024, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për MMPHI-në, kurse, ky i fundit më datë 03.03.2025, ka miratuar Raportin përfundimtar lidhur me procesin e ristrukturimit në MMPHI, më çrast ankuesja është propozuar të transferohet në pozitën Zyrtare Administrative. Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në MPB, më Vendimin MMPHI-299/2025, të datës 18.03.2025, ankuesen e ka transferuar në pozitën e rekomanduar nga Komisioni i Ristrukturimit, gjegjësisht nga pozita Përkthyes në pozitën Zyrtare Administrative në Divizionin e Buxhetit.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit MMPHI-299/2025, të datës 18.03.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/MPB, duke pretenduar se është transferuar në pozitë e klasës profesional 3, në kundërshtim me të gjitha parimet ligjore, ngase nuk janë respektuar fare procedurat ligjore lidhur me transferimin. Kërkon që të aprovohet ankesa edhe të anulohet vendimi i kontestuar me ankesë dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Bazuar në provat e lëndës të dërguar nga organi publik më datë 13.06.2025, rezulton se Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, më datë 19.05.2025, ka nxjerrë akt të ri MMPHI/02-05/2025, më të cilin ka shfuqizuar aktin e kontestuar dhe ankuesen nga pozita Përkthyes e Gjuhës Angleze e ka transferuar në pozitën Zyrtar për Përkthim në Divizionin e Përkthimeve dhe Lektyrimit, andaj, mbi këtë bazë, dhe duke qenë së kërkesa e palës ankuese në petitum të ankesës ka të bëjë me anulimin e Vendimit MMPHI-299/2025, të datës 18.03.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, vendim ky i shfuqizuar përmes Vendimit MMPHI/02-05/2025, të datës 19.05.2025, dhe meqenëse pas këtij vendimi, pala ankuese nuk ka plotësuar apo ndryshuar ankesën, atëherë, Kolegji mbi këto gjendje të rrethanave erdhi në përfundim së objekti i ankesës është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku parashihet: “*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot, si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.738/2025, të datës 28.04.2025.*

Këshillë juridike: *Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.738/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankueses Avokat Arbër Shala;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MMPHI;
- Drejtorit të DMZP-së/MPB dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.